

KREDITË E SHPEJTA

NË MAQEDONINË E VERIUT: PROBLEM APO ZGJIDHJE?



HYRJE

Shoqëritë financiare me kreditë e shpejta që ato ofrojnë u bënë temë diskutimi kohëve të fundit në saje të debatit për lojrat e fatit dhe rritjen e kostos së jetesës, duke aluduar që këto shoqëri shfrytëzojnë gjendjen e vështirë financiare të qytetarëve në kohë krize. Përveç normave jashtëzakonisht të larta të interesit, ka pasur raste të shumta të mashtrimit të qytetarëve me kredi të shpejta (1). Si pasojë, në korrik të vitit 2023 u bënë ndryshime të Ligjit për shoqëritë financiare duke vendosur rregulla dhe kufizime të tregut në mënyrë që të mbrohen konsumatorët (2).

Meqë çështja e kredive të shpejta/mikrokredive është bërë temë diskutimi në debatet publike, Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike - IDEA paraqet këtë hulumtim të shkurt në mënyrë që të hidhet dritë mbi veprimtarinë e shoqërive financiare dhe shumat e kredive të shpejta të dhëna nga viti 2018 deri në gjysmën e vitit 2023.

Të dhënat mbi shumat dhe numrin e kredive të shpejta janë marrë nga Ministria e Financave, ku me datë 30 tetor të vitit 2023 Instituti IDEA ka dërguar kërkesë për qasje në informacion me karakter publik, ndërsa Ministria e Financave është përgjigjur me datë 10 nëntor 2023.

ÇFARË JANË SHOQËRITË FINANCIARE?

Sipas Ligjit për Shoqëritë Financiare **“Shoqëri financiare është institucioni financiar jobankar i cili kryen aktivitete financiare.”** (3). Shoqëritë financiare mund të kryejnë një ose më shumë nga aktivitetet financiare në vijim: 1) miratimin e kredive; 2) dhënien dhe administrimin e kartelave kreditore; 3) faktoringun dhe 4) dhënien e garancive.

Shoqëritë financiare zakonisht njihen për dhënien e kredive të shpejta, pra kredi të cilat jepen pa kolateral apo garancion nga vendi i punës së konsumatorit. Për dallim nga bankat të cila janë persona juridik të themeluara me leje të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e të cilat themelohen dhe funksionojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Banka (4), shoqëritë financiare të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre e marrin përmes licencës të cilën e sigurojnë nga Ministria e Financave (5). Kjo nënkupton që procedura më të thjeshta të themelimit dhe operimit, si dhe kontrole më të lehta të veprimtarisë së tyre.

1. <https://civilmedia.mk/za-edna-godina-izmameni-43-gragani-so-brzi-krediti/https://prizma.mk/brzi-krediti-na-tug-grb/>

2. <https://finance.gov.mk/2023/07/19/mf-mbrojme-interesin-e-qytetareve-u-percaktuan-kostot-maksimale-per-kredite-e-shoqerive-financiare/?lang=sq>

3. Ligji për shoqëri financiare, neni 3, paragrafi 1; e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë 158/2010: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE3D29844FE253479C453BE18D8CFF87.pdf>

4. Ligji për Bankat, neni 2, paragrafi 1: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/E38C3BB1172C4841B9E274D04BC00697.pdf>

5. Ligji për Shoqëritë Financiare: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE3D29844FE253479C453BE18D8CFF87.pdf>

ÇFARË JANË KREDITË E SHPEJTA?

Kreditë e shpejtë janë një formë e hua-marrjes së parave të gatshme nga ana e qytetarëve të cilat jepen nga shoqëritë financiare. Oferta është e përhapur në treg dhe popullariteti i tyre qëndron tek fleksibiliteti apo formalitetet minimale, dhe kjo zgjidhje është kryesisht për njerëzit që kanë nevojë për para shtesë pothuajse menjëherë për të mbuluar shpenzimet e papritura ose për të shlyer borxhet e tjera.

Kreditë e shpejta janë tërheqëse për konsumatorët kryesisht për shkak të transferimit të shpejtë të fondeve i cili bëhet brenda ditës, si dhe procedurat e thjeshta të marrjes së kredisë, të cilat kërkojnë plotësimin e një formulari për kredi dhe paraqitjen e letërnjoftimit, pa nevojë për vërtetim që hua-marrësi është i punësuar, ka zhirant apo ofron kolateral.

NDRYSHIMET E FUNDIT TË LIGJIT

Ligji për Shoqëritë Financiare ka pësuar ndryshime të theksuara në vitin 2023, me qëllim të mbrojtjes më të madhe të konsumatorëve të cilët shfrytëzojnë shërbimet e shoqërive financiare. Disa nga ndryshimet më të rëndësishme janë:

- Kufizim i shumës së shpenzimeve që mund të paguhen nga marrësi i kredisë, shpenzime të cilat nuk mund të kalojnë 60% të principalit;
- Kufizimi i dhënësve të kredive edhe atë, ndalesa që shoqëritë tregtare të cilat posedojnë licencë për organizimin e lojërave të fatit të jetë ndërmjetësues kreditor i shoqërive financiare;
- Kufizimi i marrjes së kredisë nga e njëjta shoqëri financiare për të mbuluar kredinë e maturuar në të njëjtën shoqëri financiare, me çka Ligji thot: *“Shoqëria financiare nuk guxon të miratojë kredi të re konsumatore me të cilën në tërësi ose pjesërisht do të mbyll obligimet e maturuara të konsumatorit nga marrëveshja e lidhur paraprake për kredi konsumatorë në të njëjtën shoqëri financiare...”* (6).

ANALIZË E TË DHËNAVE: SA ËSHTË SHUMA E KREDIVE?

Në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë 35 shoqëri financiare me filiale të shumta, të cilat operojnë në pjesë të ndryshme të Maqedonisë së Veriut. Secila prej tyre ka filialet e saja në qytete të ndryshme, ndërsa vetëm një prej tyre të cilën Instituti IDEA e ka hulumtuar ka gjithësej 29 filiale në gjithë territorin e shtetit. Megjithatë, nuk është e qartë sa është numri total i filialeve të shoqërive financiare.

Numri total i kredive të aprovuara ndër vite është pasqyruar në Figurën 1 më poshtë. Ashtu siç mund të shihet, numri i kredive të aprovuara ka pasur rritje relativisht të shpejtë ndër vite. Për shembull, nëse në vitin 2018 ishin vetëm 101,949 kredi të aprovuara, në vitin 2022 numri total i kredive të aprovuara është rritur për **178%**, duke shkuar kështu në 284,076 kredi. Një ulje prej **-17.76%** e numrit të kredive të aprovuara vërehet në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, megjithatë që nga viti 2020 numri i kredive të aprovuara është rritur vazhdimisht deri në vitin 2022.

Figura 1




Tabela 1 Numri i kredive të aprovuara në 6 muajt e parë të viteve 2018-2023

Viti	Numri i kredive në gjashtë mujorin e parë	Rritja/zvogëlimi në numra	Rritja/zvogëlimi në %
2018	39,251		
2019	87,987	48,736	124.16%
2020	69,144	-18,843	-21.42%
2021	109,841	40,697	58.86%
2022	179,120	69,279	63.07%
2023	146,426	-32,694	-18.25%

Nëse shohim numrin e kredive të aprovuara nga prizmi gjashtë mujor (Figura 2), vërejmë që numri i kredive të shpejta në pjesën e dytë të vitit është në shumicën e rasteve më i lartë sesa ai në pjesën e parë të vitit, përveç vitit 2022 ku pjesa e parë e vitit kishte rritje të konsiderueshme nga viti paraprak. Kjo mund të shpjegohet nga rritja e shpenzimeve që familjet përfjetojnë gjatë muajve të dimrit, siç janë shpenzime për ngrohje, ushqime, etj., të cilat nuk mund t'i mbulojnë me pagat apo kursimet e tyre dhe detyrohen të marrin kredi të shpejta.

Në këtë krahasim të gjashtëmujorëve mund të shohim edhe të dhënat e siguruara për pjesën e parë të vitit 2023, ku vërehet një rënie relativisht e madhe numrit të kredive të aprovuara. Krahasuar me gjashtëmujorin e vitit 2022, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 kemi 32,694 kredi më pak të aprovuara, apo një rënie prej **18.25%**. Ky është në fakt një dallim relativisht i madh krahasuar me dy vitet paraprake të cilat përjetuan rritje enorme prej **58.86%** dhe **63.07%** krahasuar me vitet pararendëse. Megjithatë, nuk është e qartë çfarë saktësisht mund të ketë ndikuar në uljen e numrit të kredive të aprovuara.

Figura 2




TRENDI SIPAS SHUMAVE


Paralel me numrin e kredive të aprovuara, shumat e përgjithshme të kredive të shpejta të aprovuara kanë shënuar rritje enorme gjatë viteve të fundit (Figura 3). Nga 36,307,317 euro të marra si kredi në vitin 2018, kjo shumë është rritur në 137,643,919 euro në vitin 2022, apo **rritje prej 101,336,602 eurove** apo 279% krahasuar me vitin 2018. Rritja më e madhe ka ndodhur në vitin 2019 me 39,067,675 euro krahasuar me vitin 2018, ndërsa paralel me numrin e kredive të aprovuara, viti 2020 ka parë një rënie të vogël të shumës së kredive të aprovuara prej -783,106 euro.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 shuma totale e aprovuar në kredi të shpejta është 73,745,106 euro. Në krahasim me gjashtëmujorin e vitit paraprak, kjo është një rënie prej 13.98%. Pra, në aspekt të të hollave të dhëna, rënia është më e vogël krahasuar me numrin e kredive të dhëna, meqë, ashtu siç mund të shihet në Figurën 4, shuma e dhënë për kredi duket që është rritur për 3.94%.

Figura 3



Në aspekt të shumës mesatare të marrë për kredi, siç mund të shihet në Figurën 4 më poshtë, shuma mesatare për kredi gjatë 6 viteve të fundit është rritur nga 356 në vitin 2018, në 504 në gjysmën e parë të vitit 2023, duke treguar kërkesën e shtuar për shuma më të mëdha të kredive.

Figura 4

PËRFUNDIM

Ashtu siç e pamë më lartë, shoqëritë financiare janë institucione financiare të cilat funksionojnë paralel me bankat komerciale, megjithatë kanë procedura të thjeshta për dhënien e kredive të shpejta dhe të vogla, me çka paraqiten si atraktive për konsumatorët që kërkojnë kesh të shpejtë. Rritja drastike e shumës dhe numrit të kredive të shpejta të marra gjatë viteve të fundit shpërfaqin thellësinë e krizës ekonomike në të cilën gjinden një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve. Po ashtu, rritja enorme e kredive të shpejta të marra mund të jetë indikator i mvarshmërisë ndaj lojrave të fatit, edhe pse kjo mbetet në nivelin e shpekulimeve.

Disa nga konkluzionet dhe rekomandimet e Institutit IDEA janë si vijon:

- Ndryshimet ligjore mund të shihen si hap i mirë në drejtim të rregullimit të shoqërive financiare, megjithatë ekzistojnë kritika mbi atë se sa realisht këto ndryshime do të mbrojnë konsumatorët.
- E para, sa i përket ndryshimeve mbi shpenzimet të cilat mund të paguhen nga huamarrësit të cilat kufizohen në 60% të principalit të huazuar, kritikët thonë që ky ndryshim nuk shton ndonjë vlerë të theksuar meqë korniza ekzistuese ligjore - apo Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit - veçmë parasheh që shumata maksimale e shpenzimeve që mund të kthehen të jetë jo më e lartë se 55% (7). Prandaj duhet të ri-shqyrtohet efekti real i këtyre ndryshimeve ligjore.
- E dyta, edhe pse sipas ndryshimeve të fundit të Ligjit konsumatorët nuk do të kenë mundësi të marrin kredi në një shoqëri financiare për të mbuluar një kredi të maturuar në atë shoqëri financiare, ekzistojnë zbrazëtira nëpërmjet të cilave konsumatorët përsëri do të mund të “zhyten” në kurth të borxhit, p.sh. duke marrë kredi në shoqëri tjera financiare për të mbuluar kreditë e maturuara në një shoqëri financiare, etj.
- Institucionet shtetërore do të duhet të adresojnë dyshimet e ngritura në publik që një pjesë e shoqërive financiare janë themeluar me kapital të huaj të dyshimtë, me qëllim të parandalimit të krimeve financiare.
- Kur flasim për kurthet dhe mashtrimet me borxhe, Instituti IDEA inkurajon institucionet shtetërore të rrisin kontrollin dhe vëmendjen ndaj hua dhënësve individual/personave fizik, të cilët shfrytëzojnë gjendjen e rënduar financiare apo mvarshmëritë e qytetarëve për t’u huazuar para dhe pastaj marrin nga ata shumëfishin e principalit të huazuar.

7. https://ener.gov.mk/files/propisi_files/doc1/13_311753314%D0%9F%D1%80%D0%BE%D0%BF%D0%B8%D1%81_%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%B8%D1%81%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5%20%D0%B4%D1%80%D1%83%D1%88%D1%82%D0%B2%D0%B0_1.1.pdf